



**REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS / TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/  
KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL**

# **BULETINI MUJOR**

**VEPRIMTARIA PËRFAQËSUESE DHE AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS**



**Qershor 2018**

# DISKUTOHET KËRKESA BUXHETORE PËR VITIN 2019

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), ka diskutuar kërkesën buxhetore për vitin 2019 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2020-2021. Kërkesa buxhetore për rritje të numrit të punëtorëve dhe për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte temë tjetër e këtij takimi, në të cilin u shqyrtuan edhe kërkesat buxhetore të kategorive mallra e shërbime dhe investime kapitale.



# DISKUTOHET RISHIKIMI I AKTEVE NËNLIGJORE



Rishikimi i akteve nënligjore të sistemit prokurorial të Kosovës ishte temë diskutimesh

në takimin e përbashkët të anëtarëve të Komisionit për Çështje Normative të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe komisioneve të përhershme të KPK-së

Gjatë këtij takimi anëtarët e komisioneve janë pajtuar se aktet e parapara nënligjore për rishikimin e Planit të Punës së KPK-së për vitin 2018 do të ndryshohen pas miratimit të ligjeve të sistemit prokurorial të Kosovës.

Si përfundim, anëtarët u pajtuan që të bëhet rishikimi dhe ndryshimi i akteve nënligjore, të cilat nuk varen nga miratimi i ligjeve që pritet të hyjnë në agjendën e Kuvendit.

# MBAHET TAKIMI I RADHËS I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Në takimin i 153-të të Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga Kryesuesi, Blerim Isufaj, është miratuar kërkesa buxhetore e sistemit prokurorial për vitin 2019. Miratimit të kësaj kërkesë i ka paraprirë prezantimi i kësaj çështjeje nga Kryesuesi i Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel, prokurori Zejnullah Gashi dhe diskutimet e anëtareve të KPK-së.

KPK-ja ka miratuar unanimitisht edhe emrat e prokurorëve të propozuar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokuroritë e tjera, si prokurorë përgjegjës për komunikim me media, si dhe opinionin ligjor të Komisionit për Çështje Normative për pagesat në procedurën e ndërmjetësimit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka miratuar në këtë takim edhe zgjedhjen e Valon Jupës në cilësinë e Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorive, për një mandat trevjeçar me mundësi vazhdimi.



# KPK-ja CAKTON PROKURORËT PËRGJEGJËS PËR KOMUNIKIM ME MEDIA

Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së komunikimit të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, duke inkurajuar pjesëmarrjen dhe informimin e qytetarëve, rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës për opinionin e gjerë publik, si dhe në zbatim të Strategjisë për Komunikim me Publikun të këtij sistemi, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe të gjitha prokuroritë kanë propozuar për miratim në KPK nga një prokuror përgjegjës për komunikim me media. Andaj, Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e 153-të të tij ka miratuar emrat e prokurorëve përgjegjës për komunikim me media në të gjitha prokuroritë e Republikës së Kosovës.

Prokurorët e caktuar si përgjegjës për komunikim me media janë:

1. Besim Kelmendi, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
2. Xhevdet Bislimi, Prokuroria e Apelit;
3. Sylë Hoxha, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës;
4. Ibrahim Berisha, Prokuroria Themelore e Prishtinës;
5. Jetish Maloku, Prokuroria Themelore e Gjilanit;
6. Artan Çerkini, Prokuroria Themelore e Ferizajt;
7. Petrit Kryeziu, Prokuroria Themelore e Prizrenit;
8. Armend Zenelaj, Prokuroria Themelore e Gjakovës;
9. Ersan Qavolli, Prokuroria Themelore e Pejës, dhe
10. Zejnije Kela, Prokuroria Themelore e Mitrovicës.



# ANALIZOHEN VIZITAT E REALIZUARA NË 4 PROKURORI THEMELORE

Komisioni për Administrimin e Prokurorive ka analizuar të gjeturat nga vizitat e realizuara në prokuroritë themelore të Pejës, Gjilanit, Gjakovës dhe Ferizajt, si dhe ka përcaktuar kalendarin e vizitave në prokuroritë e tjera.

Komisioni ka analizuar fillimin e procesit të zbatimit të sistemit për menaxhimin elektronik të rasteve (SMIL) dhe kanë përcaktuar një plan veprimi për hapat që duhet ndërmarrë në këtë proces, përfshirë afatet kohore dhe përgjegjësit për realizimin e tyre, si dhe është përcaktuar forma dhe dinamika e monitorimit të këtij procesi.



# KRERËT E KPK-së DHE KGJK-së TAKUAN DONATORIN E PROJEKTIT "SMIL"



Krerët e sistemit prokurorial dhe gjyqësor të Kosovës, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Blerim Isufaj dhe Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizi, takuan një delegacion nga Norvegjia, të përbërë nga Arild Momberg Sande, Sven Mairus Urke dhe Stein-Ivar Lothe, të cilët ishin në cilësinë e përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë - donatore e Projektit të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Lëndëve (SMIL).

Udhëheqësit e sistemit gjyqësor dhe prokurorial njoftuan delegacionin norvegjez me progresin e realizimit të aktiviteteve kryesore të këtij projekti të rëndësishëm. Kryesuesi i KPK-së, Isufaj, njoftoi në veçanti zyrtarët e lartë norvegjezë për përgatitjen e Planit të veprimit nga ana e KPK-së për zbatimin e Sistemit për Menaxhimin Elektronik të Lëndëve (SMIL), i cili qartëson procesin për të gjithë zyrtarët përgjegjës të sistemit prokurorial dhe gjyqësor.

"KPK-ja ka rritur kapacitetet në Departamentin e Teknologjisë Informative me 3 pozita dhe tre pozita të tjera janë në proces të rekrutimit, gjë që tregon se jemi të përkushtuar për përgatitjen e propozimit të fazës së ardhshme të projektit, pra fazës e konsolidimit, duke përcaktuar obligimet konkrete që ndikojnë në qëndrueshmërinë e SMIL-it", ka pohuar z.Isufaj gjatë takimit.

# U MBAJT TRYEZË E PUNËS PËR HARTIMIN E KODIT ETIK PËR PROKURORË

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Blerim Isufaj, kryeprokurorë dhe prokurorë të prokurorive të Kosovës, si dhe zyrtarë të lartë të Sekretariatit të KPK-së morën pjesë në tryezën treditore me përfaqësues të shoqërisë civile dhe prokurorë nga Holanda.

Tryeza u mbajt në Ohër, të cilën e organizoi KDI-ja në bashkëpunim me Lëvizjen FOL dhe Qendrën për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (CILC), e financuar nga Ambasada e Norvegjisë në Kosovë.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte hartimi i draftit të Kodit të ri të Etikës për Prokurorë në Republikën e Kosovës, kurse ndër temat e trajtuara në tryezë ishin integriteti, transparenca, llogaridhënia, pavarësia, paanshmëria dhe profesionalizmi i prokurorëve, si dhe çështje të ndryshme për sjelljen etike të prokurorëve gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.






# Pilotimi i Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL)

Në Prokurorinë Themelore të Ferizajit ka filluar pilotimi i Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL).

Gjatë kësaj faze do të bëhet testimi i sistemit për Departamentin e Përgjithshëm dhe Departamentin e Krimeve të Renda për instancën e parë dhe do të vazhdohet edhe për instancën e dytë.

Pasi të përfundojë kjo fazë, do të fillojë trajnimi i stafit të Prokurorive Themelore - Prishtinë, Pejë, Gjilan, Gjakovë, Ferizaj dhe Prizren.



The image shows a login interface for the 'Prokurori i Shtetit' (State Prosecutor). At the top center is the coat of arms of Kosovo. Below it, the text 'Prokurori i Shtetit' is displayed. There are two input fields: 'Përdoruesi' (Username) and 'Fjalëkalimi' (Password). Below the password field is a checkbox labeled 'Më mbaj mend' (Remember me) and a 'Kyç' (Login) button.

# Sekretariati i KPK-së

Veprimtaria dhe aktivitetet e Zyrës së Drejtorit të Sekretariatit të KPK-së janë realizuar me mbajtjen e takimeve të shumta me ekspertë të Projektit të Binjakëzimit të BE-së me titull: “Fuqizimi i efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë”, me ç’rast janë diskutuar çështjet praktike, metodat e punës së binjakëzimit dhe çështjet e ngritjes së kapaciteteve të personelit administrativ dhe prokurorëve, duke vijuar pjesëmarrjen në trajnimin e organizuar për udhëheqësit e projekteve të binjakëzimit më 5-6 qershor në Bruksel, e gjer te proceset për integritet evropiane, ku ka vazhduar raportimi i informatave për reformat, të cilat i ka ndërmarrë KPK-ja për zbatimin e Strategjisë së Evropës Juglindore 2020.

Zyra për Komunikim me Publikun e SKPK-së ka filluar riorganizimin e veprimtarisë me një qasje proaktive ndaj sektorëve të rëndësishëm, duke filluar konkretisht zbatimin e iniciativës përfundimtare për dizajnimin e përbashkët të portalit të ri për të gjitha institucionet e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, i cili do të krijojë mundësi unike për qasje dhe transparencë në informata të shumta, duke synuar më tej krijimin e frymës bashkëpunuese në relacion me mediat dhe publikun, si dhe fuqizimin e kapaciteteve të menaxhimit të informatave, komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun.

Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme ka përgatitur kërkesën e parë buxhetore për vitin 2019 dhe vlerësimet e hershme 2020-2021 për sistemin prokurorial të Kosovës, kurse pas miratimit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, Kërkesa buxhetore 2019-2021 është dorëzuar në Kuvend dhe në Ministri të Financave.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka filluar auditimin e rregullt në Divizionin e Buxhetit dhe Financave, me ç’rast janë përpiluar me kohë objektivat dhe është mbajtur takimi fillestar me menaxhmentin, në të cilin janë diskutuar pikat kryesore gjer në përfundimin e raportit final në muajin korrik.

Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurorim dhe Administratë, ka njoftuar se gjatë qershorit në sistemin prokurorial të Kosovës kanë filluar punën 7 zyrtarë për komunikim me publikun, 39 zyrtarë ligjorë dhe 2 zyrtarë për buxhet dhe financa, si dhe kanë filluar procedurat për rekrutimin e 52 bashkëpunëtorëve profesionalë në të gjitha nivelit e institucionit të Prokurorit të Shtetit.

## Njësitë për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorive i KPK-së

Aktivitetet e Zyrës për Statistika (ZS) kanë pasur në fokus krijimin e modaliteteve profesionale për përpunimin e të dhënave për raportet statistikore për Trem II 2018. Rëndësi e veçantë i është kushtuar përgatitjes së informatave dhe të dhënave statistikore për veprat penale të terrorizmit, krimeve ekonomike, sekuestrimit të pasurisë së fituar me vepra penale, shkeljes të të drejtave të autorit dhe veprave penale të vrasjeve për periudha të ndryshme kohore sipas kërkesave të katër kandidatëve për Master. Në shërbimin institucional janë përfshirë edhe të dhënat sipas kërkesave të KE-PECK II-shit, ZBE-së, MPB-së, CEPEJ-së dhe IKD-së. Prokurorët kanë marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme në fushën e procedurës penale në temat: provat në procedurë penale, masat e fshehta dhe menaxhimi i dëshmitarit. Nga e drejta materiale, prokurorët kanë marrë pjesë në programin e specializuar për forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëllarjes së parave, kurse nga e drejta multidisiplinare, në trajnimin për mbikëqyrjen ndërkombëtare të të drejtave në vendet e privimit të lirisë. Po ashtu, Zyra për trajnime e NJSHPP-së në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës ka organizuar trajnimin për ngritjen e kapaciteteve për stafin administrativ të sistemit prokurorial të Kosovës në fushën e komunikimit me media dhe shkathtësive ligjore dhe gjyqësore për teknikat e hulumtimit ligjor.

Gjatë qershorit ka vazhduar edhe digjitalizimi i dosjeve të prokurorëve, hartimi i raporteve analitike dhe krahasimore për punën e Prokurorit të Shtetit dhe është ofruar mbështetje administrative në procesin e avancimit të prokurorëve.